

PROCES - VERBAL
Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objkti i Procedures: “Vlerësimi i Cenueshmerise, Vulonerabilitetit si dhe ekspozimi kundrejt risqeve Kibernetike per te dhenat dhe sistemet IT”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
98390000-3 Shërbimet te Tjera.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **99,631,666** (Nentedhjete e nente million e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
- **999,415** (Nenteqind e nentedhjete e nente mijë e katerqind e pesëmbëdhjetë) euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ne piken 1 te nenit 6 te ligjit 16/2024, “per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ne VKM nr. 498, dt. 01.08.2024, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyvetimit te meposhtem:

Objekt i kësaj procedure prokurimi është “Vlerësimi i Cënueshmërisë, Vulnerabilitetit si dhe Ekspozimi Kundrejt Risqeve Kibernetike për të Dhënat dhe Sistemet IT”. Kërcënimet në internet të sistemit energjetik njihen tani si rreziqe thelbësore për shoqëritë funksionuese të sigurisë, stabilitetin ekonomik dhe vazhdimësinë e biznesit. OSHEE group sh.a ka gatishmërinë për të krijuar një program sigurie të qëndrueshëm, të menduar mirë dhe të besueshëm për sigurinë kibernetike. OSHEE group sh.a duhet të organizojë veprimtaritë e saj aktuale, në pikëpamje të gjeneratës së ardhshme të asaj se çka programi ynë i sigurisë duhet të sjellë dhe të krijojë një rrugë të qartë për ndërtimin e atij programi gjatë viteve të ardhshme.

Qëllimi kryesor i projektit është implementimi i një sërë masash teknike për rritjen e sigurisë së sistemeve kritike, të rëndësishme dhe të gjitha sistemeve të tjera të infrastrukturës IT në përdorim nga OSHEE.

Masat teknike do të implementohen në disa prej kategorive më kryesore të përcaktuara në dokumentat e referencës për ligjin e sigurisë kibernetike dhe menaxhimin e sigurisë së sistemeve të OSHEE që janë:

- Menaxhimi i aseteve IT
- Mbrojtja e integritetit të rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve IT
- Zbulimi i ngjarjeve të sigurisë kibernetike
- Vlerësimi i cenueshmërisë së sistemeve IT përballë sulmeve kibernetike

Duke ditur pasojat që mund të lindin nga një sulm kibernetik, OSHEE Group ka vendosur që kjo procedure të mos jete në loto pasi **nuk mundet që të permbushen qellimet sipas kërkesave të AK nese ka disa operatore, pasi do të krijohen problem në koordinimin në kohe reale për të dhene sigurine e nevojshme.**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, në ligjin nr 16/2024 “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, për prokurimin publik”, në nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, në nenin 11 të Vendimit nr. 498 datë 01.08.2024.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe marrë persiper çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 99,631,666 (Nentëdhjetë e nente million e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) leke pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe

financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “e hapur shërbime – mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma” a” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet

se:” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

1. dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit) është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohej. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këto procedure është gjykuar që vlera e xhiros se kërkuar të jete minimalisht sa 100% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se:” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar.

Përkatësisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2021, 2022, 2023. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të

konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu te jene të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve te nenit 41, pika” c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore “përcaktohet se:” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates në nje vlere jo më të vogël se 35,000,000 (Tridhjetë e pesë milion) leke pa TVSH.

- *Për përvoja te mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të*

shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rendesise dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurrenshmerisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jete realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të nderlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 10 (dhjetë) punonjës, të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike/ Inxhinieri Informatike/Teknologji Informatike / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatike / Informatikë Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion që do të angazhohen në implementimin e projektit, stafi të jete i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, diplomë përkatëse, Çertifikate Perkatëse / Transkripte si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projektesh
- b) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për ITIL menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh
- d) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si administrator expert për endpoint Microsoft ose ekuivalent
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për sisteme virtualizimi në nivel profesional;
- f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për siguri në rrjeta;
- g) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cybersecurity;

- h) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për servera
- i) Të paktën 1 (një) person të certifikuar për Auditimin/Kontrollin e Sistemeve të Informacionit

Një punonjës mund të jetë i certifikuar në një apo me shumë certifikata të percaktuara si mësipërme.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projektsh.

Argumentim: Duke qenë se kohëzgjatja e zbatimit të kësaj kontrate është mbi 1 vit, dhe numri aktual i sistemeve dhe platformave teknologjike që ka Oshee Group sh.a., për të cilët do kryhet shërbimi i vlerësimit e testimeve profesionale, është relativisht i madh edhe kompleks, atëherë është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij, të pakten **1 punonjës të certifikuar për menaxhim projektsh** për të vënë në zbatim ekspertizën e tij profesionale për të menaxhuar e koordinuar me sukses proceset e punës/shërbimeve ndërmjet stafit të eksperteve profesionale të OE fitues me stafin e AK-se. Ky certifikim është vendosur në përputhje me madhësinë e vlerës së fondit limit të vënë në dispozicion, në proporcion ndaj të gjithë profileve të eksperteve të sigurisë kibernetike dhe menaxheriale të kërkuar në këtë prokurim dhe bazuar në kompleksitetin e infrastrukturës dhe platformave teknologjike ekzistuese të Oshee Group sh.a. që aktualisht kanë një numër tepër të madh punonjësish që do afektohen apo ndërthurin punën e tyre gjatë zbatimit të kontratës në fjalë.

b. Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për ITIL menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente.

Argumentim: Certifikimi për (ITIL) është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit të suportit gjatë implementimit, në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të Autoritetit Kontraktor. Duke pasur **dy punonjës të certifikuar për ITIL**, operatori ekonomik tregon përkushtim ndaj cilësisë dhe menaxhimit të shërbimeve IT në përputhje me standardet më të mira. Kjo ndihmon në sigurimin e një menaxhimi efektiv dhe të strukturuar të shërbimeve, duke përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e ofruar.

Kërkesa për dy punonjës të certifikuar për ITIL menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente, vendoset në përputhje me madhësinë e projektit dhe vlerën e fondit limit të vënë në dispozicion. Kjo siguron që projekti të menaxhohet në mënyrë profesionale dhe efektive, duke minimizuar rreziqet dhe duke siguruar një zbatim të suksesshëm dhe koordinim efektiv ndërmjet stafit të profesionistëve të operatorit ekonomik dhe stafit të Autoritetit Kontraktor.

c. **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si testues sistemesh.**

Argumenti: Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të ketë të paktën një punonjës të certifikuar si testues sistemesh për të garantuar suksesin dhe sigurinë e projektit. Kjo kërkesë është thelbësore pasi projekti përfshin siguri kibernetike, sisteme mbrojtjeje dhe faze të dedikuara për testimin dhe penetrimin të sistemeve. Një testues i certifikuar sjell ekspertizën e nevojshme për të identifikuar dhe adresuar dobësitë në sisteme, duke siguruar që ato të funksionojnë pa probleme dhe të jenë të mbrojtura nga kërcënimet kibernetike. Testimi është një kriter në propozicionin me nevojat teknike të projektit dhe shërben si garanci për realizimin e një faze të rëndësishme sic është testimi.

d. **Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si administrator expert për endpoint Microsoft ose ekuivalent.**

Argumenti: Të paktën 4 (kater) punonjës të certifikuar si administrator expert për endpoint Microsoft ose ekuivalent për të përmbushur me profesionalizëm shërbimin e instalimit, konfigurimit dhe mirëmbajtjes. Këto sisteme do të konfigurohen për të patur disponueshmëri shumë të lartë 24/7, cka e bën të domosdoshme prezencën në stafin e Operatorit Ekonomik për specialiste të këtij profili duke qenë se fokusi kryesor janë endpoint e klientit.

e. **Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për sisteme virtualizimi në nivel profesional.**

Argumentim: Në kontekstin e projektit që do të prokurohet një pjesë e arkitekturës do të jetë e virtualizuar. Për të siguruar që kjo pjesë e virtualizuar e arkitekturës të jetë implementuar dhe menaxhuar në mënyrë të duhur, operatori ekonomik duhet të vendosë në dispozicion të kontratës dy punonjës të certifikuar për virtualizim, duke garantuar në këtë mënyrë realizimin e një komponenti të rëndësishëm teknik të projektit.

f. **Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për siguri në rrjeta.**

Argumenti: Kërkesa për të pasur të paktën dy punonjës të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike është e rëndësishme për sigurinë dhe efikasitetin e rrjetave kompjuterike për natyrën sensitive të punës që ka AK. Punonjësit e certifikuar për rrjeta kanë njohuri të thelluara për identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë, ku përfshihet networking, duke siguruar mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga potenciale rreziqe të tilla. Kërkesa është hartuar në përputhje me specifikimet teknike në të cilat parashikohen shërbime të dedikuara mbi sigurinë. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë përvojën profesionale për realizimin e kontratës.

g. Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cybersecurity.

Argumenti: Kërkesa për të pasur të paktën dy punonjës të certifikuar për Cybersecurity është thelbësore për sigurinë dhe efikasitetin e sigurisë kibernetike, duke marrë parasysh natyrën sensitive të punës që kryen Autoriteti Kontraktor. Punonjësit e certifikuar për Cybersecurity kanë njohuri të thelluara në identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë, duke përfshirë

sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga kërcënimet potenciale. Këta punonjës janë të aftë të analizojnë dhe zbatojnë masa të avancuara për të mbrojtur sistemet nga sulmet kibernetike, viruse, malware dhe çdo lloj rreziku tjetër që mund të kompromentojë integritetin dhe funksionalitetin e infrastrukturës dhe sistemeve që do të implementohen. Ata kanë përvojën dhe aftësitë e nevojshme për të zbatuar politika dhe protokolle të sigurisë që minimizojnë rreziqet dhe maksimizojnë mbrojtjen e të dhënave dhe sistemeve. Kërkesa për dy punonjës të certifikuar për Cybersecurity është hartuar në përputhje me specifikimet teknike të projektit, ku siguria kibernetike ka rol parësor.

h. Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për servera.

***Argumenti:** Implementimi i infrastrukturës dhe sistemeve do të kryhet në serverat aktuale të Autoritetit. Për shkak të impaktit dhe sensitivitetin që Autoriteti Kontraktor ka, ky shërbim mund të kryhet vetem nga specialistë me njohuri të thelluara për pajisjet server, proceset që ato mbulojnë dhe mënyrën si do të ndërveprojnë me infrastrukturën e re. Kriteri për të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për servera, është tërësisht në përputhje me natyrën dhe përmasat e projektit, dhe shërben si garanci për realizimin me sukses të tij.*

i. Të paktën 1 (një) person të certifikuar për Auditimin/Kontrollin e Sistemeve të Informacionit

***Argumenti:** Kërkesa për të pasur të paktën një person të certifikuar për Auditimin/Kontrollin e Sistemeve të Informacionit është kyçe për garantimin e integritetit, sigurisë dhe performancës së përgjithshme të infrastrukturës teknologjike të Autoritetit Kontraktor. Ky person i certifikuar ka aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kryer auditime të detajuara dhe kontrole të sistemeve të informacionit, duke siguruar që të gjitha proceset dhe operacionet janë në përputhje me standardet dhe rregulloret ne fuqi mbi sigurinë. Një person i certifikuar për Auditimin/Kontrollin e Sistemeve të Informacionit është i trajnuar për të identifikuar dhe vlerësuar dobësitë dhe rreziqet potenciale brenda sistemeve, duke rekomanduar masa korrigjuese për të përmirësuar sigurinë dhe efikasitetin. Ai mund të zbatojë një qasje të strukturuar dhe metodike për të shqyrtuar dhe vlerësuar sistemet e informacionit, proceset e menaxhimit të të dhënave dhe procedurat e sigurisë, duke siguruar që të gjitha komponentët e sistemit funksionojnë në mënyrë optimale dhe të sigurt. Për më tepër, auditimi i rregullt dhe i mirëkualifikuar i sistemeve të informacionit ndihmon në identifikimin e mangësive të mundshme përpara se ato të bëhen problem serioz, duke kontribuar në një menaxhim më të mirë të riskut dhe në ruajtjen e integritetit të të dhënave. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për natyrën sensitive të punës që kryen Autoriteti Kontraktor, ku siguria e informacionit dhe besueshmëria e sistemeve kanë rëndësi të vecantë.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ISO 27001 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme), ISO 20000 – 1 ose ekuivalente për menaxhimin e shërbimeve IT (të vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marre përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Konkretisht:

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.
- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 27001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshem.

Theksojme se në të gjitha procedurat ku është vendosur si kërkesë që OE të disponojnë ISO 27001 nga ana e njesisë është përditësuar standarti duke kërkuar ISO 27001:2022 (pas konsultimit me fagen zyrtare të DPS), por nga ana e KPP-se nëpërmjet me vendimin Nr. 376/2024 datë 18.04.2024 është arsyetuar mbështetur edhe në përgjigjen që ka marre nga DPA (citojme pjesë nga arsyetimi: Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 714/6 prot., datë 08.03.2024 “Kërkesë për 12 informacion” ju informojmë se certifikatat e lëshuara sipas ISO/IEC 27001:2013 nga OVK e akredituar nga DPA, për klientët e tyre, janë të vlefshme deri në datë 31.10.2025. Forumi Ndërkombëta i Akreditimit (IAF) ka vendosur një periudhë tranzitore 3 vite

(36 muaj) për kalimin nga standardi ISO/IEC 27001:2013 në standardin ISO/IEC 27001:2022. Referuar dokumentit IAF MD 26:2022, versioni 1, periudha e tranzicionit për standardin ISO/IEC 27001:2022 do të vazhdojë deri në datë 31 tetor 2025) që iso ISO 27001:2013 është e vlefshme gjate periudhes tranzitore deri në datë 31 tetor 2025.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 20000-1 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjise së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorine e mbrojtjes kibernetike.

- 2.3.4.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose distributori të autorizuar për të gjitha licensat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax, email, website, këto të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 6 e nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që zotëron autorizimin e nevojshëm për të lëvruar mallra dhe software e kërkuara në këtë prokurim. Kjo do të conte në minimizimin e risqeve që mund të vijnë për shkak të mospërmbushjes së kontratës nga operatori për shkaqe që lidhen me marrëdhënien e biznesit midis operatorit dhe prodhuesit të pajisjeve, duke siguruar që kanali i furnizimit është i njohur dhe i autorizuar. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, krijon gjithashtu garancinë se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin të këtyre mallrave pranë autoritetit. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standartet . Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

- 2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një zgjidhje teknike, në të cilën të përfshihet propozimi i një draft plani të detajuar për shërbimet e implementimit dhe konfigurimit të pajisjeve dhe sistemeve që janë objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 6 e nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë një zgjidhje teknike, duke përfshirë propozimin e një draft plani të detajuar për shërbimet e implementimit dhe konfigurimit të pajisjeve dhe sistemeve që janë objekt prokurimi, për disa arsye të rëndësishme. Së pari, kjo kërkesë siguron që operatorët ekonomikë të kenë një plan të qartë dhe të strukturuar për realizimin e projektit, duke përfshirë të gjitha fazat e implementimit dhe konfigurimit. Kjo ndihmon në vlerësimin e kapacitetit të operatorëve për të kryer punën në mënyrë efektive dhe brenda afateve të përcaktuara. Së dyti, një plan i detajuar lejon Autoritetin Kontraktor të bëjë një analizë të thellë të metodologjive dhe teknikave të propozuara, duke siguruar që ato përputhen me kërkesat dhe standardet teknike të projektit. Së fundi, ky kriter ndihmon në identifikimin e operatorëve që kanë eksperiencën dhe aftësinë për të menaxhuar sfidat e mundshme gjatë procesit të implementimit dhe konfigurimit, duke minimizuar rreziqet dhe duke siguruar një zbatim të suksesshëm dhe efikas të projektit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke iu referuar rëndësisë që furnizimi me energji ka në jetën e sotme sociale-ekonomike, infrastruktura e OSHEE-së mund të konsiderohet jetike, me një ndikim të gjerë në jetën e përditshme të Shqipërisë. Në të kaluarën, sistemet e IT ishin të izoluara, ndërsa sfida e sotme është lidhja e disa sistemeve së bashku nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të të dhënave të shumëfishta. Ky shkëmbim gjithnjë në rritje i të dhënave dhe faktorëve të tjerë, përbëjnë një rrezik të madh për infrastrukturën e OSHEE-së në aspektin e Sigurisë Kibernetike. Kërcënimi nga sulmet keqdashëse është i pashmangshëm, në qoftë se nuk ka kundërmasa të sakta dhe protokolle të detajuar të mbrojtjes nga këto sulme. Në kontekstin e një peizazhi të kërcënimit kibernetik në zhvillim të shpejtë, OSHEE sh.a. është e vetëdijshme se realizimi i sigurisë kibernetike dhe zbutja e risqeve janë kritike për të mbështetur operacione të besueshme, në kohë, të sigurt dhe efikase., në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, për produktet/shërbimet/garancitë objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Termat e References/Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe

standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.